

Lista e Projekteve për Vitin 2020

1. Përditësimi Gjeo-hapësinor i të dhënave të Lejeve Minerare (4,0 mil)

Ky Projekt bën shqyrtimin dhe përditësimin e të gjitha ndryshimeve në lejet minerare, si ndryshim koordinatash, ndryshim sipërfaqeje ose shtyrje afati. Përditësimi i zonave dhe fronteve ku është punuar në periudhën vjetore, detyrimet financiare të shlyera dhe të pa shlyera përsa i përket garancive të investimit e rehabilitimit dhe rentës minerare. Përveç përditësimit në rregjistrin e lejeve minerare përditësimet bëhen edhe në sistemin GIS e Google Earth për zonat në total dhe AutoCad punimet e detajuara.

Projekti lidhet me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, sepse dixhitalizon një pjesë të rëndësishme të të dhënave kombëtare mbi burimet minerare dhe i ve në dispozicion të Autoritetit shtetëror për informacion Gjeo-hapësinor (ASIG).

Gjithashtu, përditësimi i të dhënave të industrisë minerare bën pjesë në deklaratën e prioriteteve të Qeverisë, e cila ka për qëllim lehtësimin e politik-bërjen në këtë fushë të ekonomisë.

2. Mbikëqyrja e shfrytëzimit të burimeve minerare metalore dhe jometalore, (15,2 mil)

Në zbatim të politikave qeverisëse (*ligji Nr 10304, datë 15.7.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij*), Drejtoria Minerare, kontrollon shfrytëzimin e burimeve minerare, në zbatim të ligjit të mësipërm. Në këtë ligj, është përcaktuar saktë dhe qartë që çdo objekt minerar dhe subjekt i cili shfrytëzon këtë objekt, duhet t'i nënshtrohet 2 herë në vit, aktivitetit mbikqyrës, nga struktura të specializuara në AKBN, nga Sektori i Mbikqyrjes së Mineraleve Metalorë. Mbikqyrja e aktivitetit minerar të grup mineraleve metalor mundëson:

- Zbatimin e politikave të qeverisë në fushën minerare;
- Kontrollon aktivitetin e liçensuar minerar;
- Kontrollon dhe verifikon mënyrën dhe formën e shfrytëzimit të rezervave minerare;
- Verifikon zbatimin e projekteve të hapjes dhe shfrytëzimit për objektet minerare;
- Evidenton të metat dhe mangësitë e aktivitetit dhe merr masa për eliminimin e tyre;
- Monitorimin e zonave dhe sipërfaqeve të shfrytëzuara;

Gjatë mbikqyrjes, grupi i realizimit të projektit, verifikon dhe zbatimin e detyrimeve të tjera që kanë subjektet e pajisur me leje minerare, konkretisht:

- Pagesën e garancisë së investimeve dhe verifikimin e investimeve të realizuara;
- Pagesën e garancisë së reabilitimit dhe sipërfaqet e prekura dhe të rehabilituara;

3. Studim mbi zonimin minerar dhe hartimi i planit vjetor e 3-vjeçar minerar (3,0 mil lek)

Përcaktimi i zonave të reja minerare kërkon studim të zonave ekzistuese, kërkesave dhe bashkëpunim me struktura të tjera. Studimi mbi zonimin minerar realizohet me qëllimin e përcaktimit të zonave të reja minerare me perspektivë për shfrytëzimin e mineraleve të grupit ndërtimor dhe metalor nisur edhe nga nevojat aktuale të ekonomisë shqiptare për këto pasuri natyrore. Aktualisht, në vendin tonë industria minerare zhvillohet nga subjekte private dhe shtetërore, të cilët, nisur nga nevojat e ekonomisë së vendit paraqesin interesin

e tyre për ushtrimin e aktivitetit në këtë sektor. Qëllimi i këtij studimi është përcaktimi i kriterëve për përcaktimin e zonave të reja perspektive (si në sektorin ndërtimor ashtu edhe atë metalor) në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Shfrytëzimi i burimeve minerare metalore, minerare zhvillohet në zbatim të kuadrit ligjor, veçanërisht në ligjin Nr 10304, datë 15.7.2010, “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Në zbatim të këtij Ligji, Drejtoria Minerare, si strukturë përgjegjëse, kontrollon shfrytëzimin e burimeve minerare ekzistuese dhe është detyrë e saj përcaktimi i zonave të reja me perspektivë për shfrytëzim.

Në Ligjin Mineral, është përcaktuar saktë edhe detyra e Sektorit të Akt - Verifikimeve për verifikimin në terren të zonave minerare të shpallura, si dhe përcaktimin e zonave minerare perspektive. Është detyrë funksionale e këtij sektori (parashikuar edhe në rregulloren e AKBN-së për Drejtorinë Minerare) që për çdo zonë të kryejë verifikimin në terren sa i përket vendndodhjes së tij, llojin e mineralit, mënyrën sa me efëcente të shfrytëzimit, sasinë e rezervave minerare, lidhjen me infrastrukturën ekzistuese dhe për caktimin e kufizimeve për mosdëmtimin e saj, etj.

4. Promovimi i mineraleve të rinj dhe kërkimeve teknologjike dhe mjedisore (3,5 mil lek)

Promovimi i mineraleve të rij dhe mundësia për të rritur teknologjinë e prodhimit dhe përpunimit me sa më pak efekte mjedisore. Përcaktimi i zonave të reja minerare kërkon studim të zonave ekzistuese, kërkesave dhe bashkëpunim me struktura të tjera. Studimi mbi zonimin mineral realizohet me qëllimin e përcaktimit të zonave të reja minerare me perspektivë për shfrytëzimin e mineraleve të grupit ndërtimor dhe metalor nisur kjo edhe nga nevojat aktuale të ekonomisë shqiptare për këto pasuri natyrore. Aktualisht, në vendin tonë, industria minerare zhvillohet nga subjekte private dhe shtetërore, të cilët, nisur nga nevojat e ekonomisë së vendit paraqesin interesin e tyre për ushtrimin e aktivitetit në këtë sektor. Qëllimi i këtij studimi është përcaktimi i kriterëve për përcaktimin e zonave të reja perspektive (si në sektorin ndërtimor ashtu edhe atë metalor) në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Shfrytëzimi i burimeve minerare metalore, zhvillohet në zbatim të kuadrit ligjor, veçanërisht në ligjin Nr 10304, datë 15.7.2010, “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Në zbatim të këtij Ligji, Drejtoria Minerare, si strukturë përgjegjëse, kontrollon shfrytëzimin e burimeve minerare ekzistuese dhe është detyrë e saj përcaktimi i zonave të reja me perspektivë për shfrytëzim.

Në Ligjin Mineral, është përcaktuar saktë edhe detyra e Sektorit të Akt - Verifikimeve për verifikimin në terren të zonave minerare të shpallura, si dhe përcaktimin e zonave minerare perspektive. Është detyrë funksionale e këtij sektori (parashikuar edhe në rregulloren e AKBN-së për Drejtorinë Minerare) që për çdo zonë të kryejë verifikimin në terren sa i përket vendndodhjes së tij, llojin e mineralit, mënyrën sa me efëcente të shfrytëzimit, sasinë e rezervave minerare, lidhjen me infrastrukturën ekzistuese dhe për caktimin e kufizimeve për mosdëmtimin e saj, etj.

Promovimi i mineraleve të rinj dhe kërkimeve teknologjike dhe mjedisore mundëson:

- Zbatimin e politikave të qeverisë në fushën minerare;
- Verifikon mënyrën dhe formën ekzistuese të shfrytëzimit të rezervave minerare, si dhe

- promovon minerale e vendburime të reja dhe përmirësime në teknologjinë e nxjerrjes e shfrytëzimit.;
- Evidenton kufizimet gjatë ushtrimit të aktivitetit dhe paracakton masat për eliminimin e ndikimit të tyre dhe jo vetëm;
- Përcakton mundësitë për riaktivizimin e zonave të shfrytëzuara më parë dhe përcaktimin e zonave të reja perspektivë për shfrytëzim.

5. Raport vjetor mbi gjendjen mjedisore në industrinë minerare dhe metalurgji (4,0 mil)

Industria minerare me aktivitetin e saj në kërkim, zbulim, nxjerrje, përpunim dhe metalurgji, është industri e cila ka ndikimin e saj në mjedis.

Konkretisht kemi të bëjmë me objekte industriale të tilla si:

- Objekte të trashëguara jo aktive:

Në këto objekte bëjnë pjesë ish minierat e mbyllura të mineralit të qymyr gurit, bakrit dhe hekur nikelit, ish fabrikat e pasurimit të mineralit të bakrit dhe hekur nikelit, si dhe vend depozitimet e sterileve të nxjerra nga miniera dhe sterileve të ish fabrikave të pasurimit. Objektet e metalurgjisë së bakrit të barktisura dhe të demoluara.

Të gjithë këto objekte janë të mbyllur dhe jashtë kontrollit. Ato nuk mirëmbahen. Shumë prej tyre janë burim ndotës i mjedisit, dhe elementëve të tij, ajrit, tokës dhe veçanërisht të burime ujore, përranj dhe lumenj që janë pranë tyre, duke shkarkuar ujra të ndotura, me metale të rënda, si S, Fe, Ni, Co, Zn, etj..

Gjëndja e këtyre objekteve të braktisura, përkeqësohet vazhdimisht, duke rënduar dhe mjediset rreth tyre e më gjërë.

- Objekte aktivë:

Në këto objekte bëjnë pjesë të gjitha minierat nëntoksore dhe sipërfaqësore të hapura dhe të ndërtuara pas viteve 90, të shekullit të kaluar, fabrikat e pasurimit të mineralit të kromit, janë rreth 12 fabrika në të gjithë vendin të ndërtuara pas viteve 2000, dhe metalurgjia aktive e trashëguar.

Pavarsisht se shumica e tyre është ndërtuar pas viteve 2000, disa prej tyre janë burim ndotës.

Bazuar në situatën e paraqitur më sipër, si dhe në detyrimet ligjore të përcaktuara në kaudrin ligjor minerar e mjedisor, veçanërisht në ligjin Nr 10304, datë 15.7.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar dhe kuadrin ligjor në zbatim të tij, shtrojnë problemin se duhet investuar për të krijuar një pasqyrë sa më reale dhe të detajur mbi gjëndjen mjedisore në industrinë minerare.

Projekti synon kryesisht që të zgjidhë problematikat e përmendura më sipër nëpërmjet:

- Pasqyrimin të gjëndjes mjedisore në miniera dhe metalurgji;
- Evidentimin e burimeve ndotës nga aktivitetet minerare dhe metalurgjike, aktivë dhe pasivë, (të trashëguar);
- Evidentimin e shkallës së ndotjes nga këto burime;
- Evidentimin e elementëve ndotës, në lloj dhe sasi,
- Masat për parandalimin e ndotjes dhe kufizimin e saj.

6. Monitorimi i fenomeneve të postshfrytëzimit në minierat e mbyllura, me vlerë (6.4 mil)

Bazuar në ligjin nr. 10 304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të amenduar struktura përgjegjëse (AKBN-ja), përveç të tjerave, ka për funksion “monitorimin minerar e postminerar të minierave të mbyllura dhe në regjim konservimi” (neni 43, pika ç). Kostot financiare për realizimin e monitorimit postminerar përballohen nga buxheti i shtetit (neni 54, pika 2, germa ç, e ligjit minerar).

Nga eksperiencia botërore, si dhe eksperiencia minerare në vendin tonë kemi konstatuar se:

Me mbylljen e aktivitetit minerar në një minierë, ajo nuk pushon, nuk rri në gjendje qetësie, por është në vetë aktivitet të përhershëm. Kjo pasqyrohet në uljen e sipërfaqes së minierës, daljen e hapësirave të shfrytëzimit në sipërfaqe, shembjen e punimeve minerare horizontale, të pjerrëta e vertikale, (puse nëntokësor e sipërfaqësor, galeri, traverbangje, etj.), lëvizjen e pjesëve të veçanta të shkëmbinjve rrethues, etj. Këto janë si rezultat i fenomeneve post minerare që vazhdojnë në një minierë të mbyllur.

Si pasojë e veprimeve të mësipërme post minerare, objektet që ndodhen brenda fushës minerare dhe zonës së influencës, duke përfshirë dhe infrastrukturën, ndikohen nga fenomenet postminerare duke pësuar plasje, shkëputje, ndarje, deri në shembje, etj.

Minierat e mbyllura dhe të braktisura, në vazhdimësi shoqërohen me një sërë problemesh që lidhen me:

- Fenomenet e lëvizjes së sipërfaqes së tokës mbi zonat minerare të shfrytëzuara (hinka, zhvendosje, deformime ulje dëmtime të elementeve të infrastrukturës etj).
- Drenazhimin/shkarkimin e ujërave acide të minierave apo të dambave të sterileve të pasurimit.
- Ndryshimet cilësore dhe sasiore të ujërave që dalin nga minierat si edhe ato të zonës përreth.
- Lëvizje të stoqeve të sterileve të dala nga minierat.
- Lëvizje, rrjedhje, zhvendosje dhe dëmtime të digave dhe argjinaturave të dambave të ish fabrikave të pasurimit.
- Ndotjen potenciale të mjedisit (tokës dhe të ujërave rrjedhës), veçanërisht nga shpëlarja acide e sterileve të dambave nga ujërat që kalojnë nëpër to.

Arsyet për nevojën e ndërhyrjes së qeverisë

Sot në vendin tonë kemi të mbyllura përkohësisht me projekte rreth 150 miniera, shumica të cilave nuk monitorohen rregullisht për mungesë infrastrukture (ambiente, mjete pune si pajisje e aparatura fushore e laboratorike monitorimi) dhe financimit. Duhet të kujtojmë gjithashtu që, jo rrallë, në objektet e minierave të mbyllura kanë ndodhur aksidente të rënda me viktima të shumta (persona që kanë hyrë në miniera për të marrë skrape metalikë, etj.).

Pjesa më e madhe e problemeve mjedisore në industrinë minerare është e trashëguar nga veprimtaria minerare e zhvilluar para viteve të shekullit të kaluar. Kuadri ligjor përcakton se për veprimtari minerare para vitit 1990, është qeveria ajo e cila do të bëjë vlerësimin dhe do të bëjë ndërhyrjen përfshirë dhe mjetet financiare për rehabilitim

Minierat kanë qenë dhe mbeten pronë e shtetit dhe Ministria e Energjisë dhe Industrisë është direkt përgjegjëse për to si përfaqësuese e Qeverisë.

Minierat janë pjesë përbërëse e strategjisë së zhvillimit kombëtar, strategji e hartuar nga Qeveria, gjithashtu ato akoma nuk kanë kaluar në vartësi të pushtetit lokal apo të individëve. Siç u theksua më lart “monitorimi postminerar i minierave të mbyllura (braktisura)” është parashikuar në legjislacionin minerar në fuqi.